



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

QËNDRIM PUBLIK

**I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË DHOMËS KOMBËTARE TË
PËRMBRUESVE GJYQËSORË PRIVATË**

Drejtuar:

INSTITUCIONEVE PUBLIKE DHE OPINIONIT PUBLIK

Sot, më datë 21.12.2023, Ne, Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, që jemi organi më i lartë i përfaqësimit dhe vendimmarrjes së kësaj organizate juridike, vendosëm të mbajmë këtë qëndrim publik:

Shërbimi i Përmbaimit Gjyqësor Privat në Shqipëri është në rrezik.

I rrezikuar si profesion. I goditur si imazh publik. I anatemuar tek organet drejtuese të tij.

Profesioni ynë është goditur rëndë nga mosfunksionimi i hallkave shtetërore, në tërësi, ku spikat vitet e fundit, pavëmendja qeveritare ndaj incentivave ekonomike të këtij shërbimi juridik dhe mosfunksionimi konform kërkesave ligjore i disa enteve shtetërore.

Mungesa e eficiencës së gjykatave në erën e sistemit të ri të drejtësisë është një tjetër rrezik që e kanos këtë profesion çdo ditë dhe më tepër.

Imazhi publik i përmbauesit privat është goditur rëndë, nga disa individë me licencë përmbauesi, që i refuzojmë të jenë pjesë e jona. Ne i kemi denoncuar publikisht ata që, bashkë me kompanitë mikrofinanciare guxuan të mashtrjnë mijëra qytetarë, me sekuestrime, ankande dhe procedura fiktive përmbaimit.

Ne, kërkojmë nga organet e drejtësisë të vendosin forcën e ligjit, mbi këta “përmbaues” që përdhosën profesionin dhe dhunuan qytetarët në emër të tij.

Ne i dënojmë ata, njësoj si bashkëpunëtorët e tyre, jashtë shërbimit përmbaues, të angazhuar së fundmi në përpjekje të vazhdueshme për të anatemuar imazhin përfaqësues të Dhomës.

Ne, Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, nuk do të lejojmë asnjë individ, me apo pa licencë përmbauesi; asnjë entitet brenda apo jashtë shërbimit përmbaues, të diskutojë ose vërë në dyshim vullnetin tonë, për të zgjedhur përfaqësuesit tanë.

Kryetari aktual i Dhomës, ashtu si gjithë organet drejtuese, është zgjedhur në një proces votimi të lirë dhe përfaqëson vullnetin absolut të shumicës së Asamblesë së Përgjithshme, përpara pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, në interes të trupës së përmbauesve gjyqësorë privatë.

Çdo përpjekje për të cenuar imazhin dhe veprimtarinë e Kryetarit të Dhomës, i cili ka përfaqësuar në çdo kohë dhe më së miri interesat legjitime të anëtarësisë, në përputhje me ligjin dhe me tagrat e përfaqësimit të përcaktuara në Statut, konsiderohet cenim i imazhit dhe veprimtarisë së gjithë Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë.

Inkurajojmë institucionet dhe opinionin publik ta shohin përmbauesin gjyqësor privat si aleatin e tyre, në misionin e vështirë të rifitimit të terrenit të humbur të Drejtësisë.